

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **611-26-3060-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Instalimi nxemjeve qendrore-riparimi i kulmit ne SHFMU Xheladin Gashi-Plaku Komoran**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Treing SH.P.K.
NUI	812136522
Adresa	Rruga Dëshmorët e Ponoshecit, 69
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	049293969
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Uljan Thaçi
Adresa elektronike	3ingshpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	01.06.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Instalimi nxemjeve qendrore-riparimi i kulmit ne SHFMU Xheladin Gashi-Plaku Komoran

Njoftimi për kontratë: 05.05.2026

Hapja e paraparë e tenderëve: 25.05.2026

Kërkesa për rishqyrtim pranë AK: 19.05.2026

Vendimi nga AK: 22.05.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

-Kërkesa për rishqyrtim

-Vendimi i AK

-Dosja e tenderit

-Paramasa dhe patallogaria

-Pergjigje nga AK

-Raporti i ekspertit 2026/0268 për kritere të ngjashme

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur

nenin 1 dhe 6 të LPP Nr. 04/L-042;

AK ka shkelur nenin 7 të LPP Nr. 04/L-042;

AK ka shkelur nenin 27 të LPP Nr. 04/L-042;

AK ka shkelur nenin 69 të LPP Nr. 04/L-042;

AK ka shkelur nenin 17 të RRPP-001/2022;

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIMI NR. 1

Kërkesa për Inxhinier të Menaxhimit të Emergjencave dhe Ekspert të Mbrojtjes nga Zjarri është joproporcionale

AK ka kërkuar një Inxhinier të diplomuar ose Master në Menaxhimin e Emergjencave, të licencuar si ekspert i SSHP-së dhe mbrojtjes nga zjarri.

Megjithatë, nga paramasa e projektit rezulton se objekti i kontratës ka të bëjë me instalimin e ngrohjes qendrore, renovimin e nyjeve sanitare dhe riparimin e kulmit. Në projekt nuk figurojnë sisteme të mbrojtjes nga zjarri, sisteme sprinkler, hidrante, sisteme alarmi apo punime të tjera të specializuara që do ta bënin të domosdoshëm angazhimin e këtij profili profesional.

Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK nuk ka sqaruar se cilat pozicione të paramasës kërkojnë angazhimin e një eksperti të tillë, por është mjaftuar vetëm me konstatimin e përgjithshëm se kriteret janë në përputhje me natyrën e projektit.

Për rrjedhojë, kjo kërkesë nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës dhe paraqet kufizim të panevojshëm të konkurrencës.

PRETENDIMI NR. 2

Kërkesa për Inxhinier të Elektroteknikës me minimum 7 vite përvojë është joproporcionale

AK ka kërkuar një Inxhinier të Elektroteknikës me minimum shtatë vite përvojë profesionale.

Punimet elektrike të parapara në projekt janë punime standarde përcjellëse të renovimit dhe instalimit të ngrohjes qendrore. Në projekt nuk figurojnë sisteme industriale, nënstacione elektrike, rrjete të tensionit të lartë apo instalime komplekse që do të justifikonin një nivel të tillë përvojë.

AK nuk ka paraqitur asnjë arsytim teknik se pse kërkohen pikërisht shtatë vite përvojë profesionale dhe si ndikon kjo kërkesë në realizimin e kontratës.

Për rrjedhojë, kjo kërkesë është vendosur në mënyrë arbitrare dhe është në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit.

PRETENDIMI NR. 3

Kërkesa për Inxhinier të Gjeodezisë është joproporcionale

AK ka kërkuar një Inxhinier të Gjeodezisë të licencuar.

Në paramasë nuk figuron asnjë punim që kërkon incizime gjeodezike, piketim të objekteve, matje topografike apo shërbime të tjera profesionale të gjeodezisë.

Projekti ka të bëjë me renovim të objektit ekzistues dhe jo me ndërtim të ri apo infrastrukturë lineare.

AK në vendimin e saj nuk ka arsytuar se për cilat pozicione të projektit nevojitet angazhimi i një gjeodeti.

Për rrjedhojë, kërkesa për një Inxhinier të Gjeodezisë të licencuar nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës dhe paraqet kufizim të panevojshëm të konkurrencës.

PRETENDIMI NR. 4

Kërkesa për Inxhinier të Mjedisit është joproporcionale

AK ka kërkuar një Inxhinier të Mjedisit të certifikuar nga AME.

Në paramasë nuk figurojnë aktivitete që lidhen me rehabilitim mjedisor, trajtim të mbeturinave të rrezikshme, monitorim të ndotjes apo procese të tjera që kërkojnë mbikëqyrje profesionale mjedisore.

AK nuk ka treguar se cilat pozicione të projektit e bëjnë të domosdoshëm këtë profil profesional.

Prandaj kjo kërkesë nuk lidhet me natyrën e kontratës dhe tejkalon nevojat reale të projektit.

PRETENDIMI NR. 5

Kërkesa për Teknik të Arkitekturës të certifikuar ose licencuar është e paqartë dhe joproporcionale

AK ka kërkuar Teknik të Arkitekturës të certifikuar ose licencuar për punë ndërtimore.

Megjithatë, nuk është specifikuar lloji i certifikimit apo licencës së kërkuar dhe nuk është sqaruar institucioni kompetent që e lëshon atë.

AK po ashtu nuk ka arsyetuar pse një Bachelor i Arkitekturës apo kualifikim më i lartë profesional nuk konsiderohet i pranueshëm.

Për rrjedhojë, kjo kërkesë krijon paqartësi gjatë vlerësimit të ofertave dhe kufizon konkurrencën pa bazë objektive.

PRETENDIMI NR. 6

Kërkesa për Teknik Hidro me minimum 15 vite përvojë është joproporcionale

Sipas paramasës, punimet hidro përfshijnë vetëm instalime standarde të ujësjellësit dhe

kanalizimit.

Në projekt nuk figurojnë sisteme komplekse hidroteknike, impiante trajtimi, rezervuarë apo objekte të tjera të kësaj natyre.

Përkundër kësaj, AK ka kërkuar Teknik Hidro me minimum 15 vite përvojë pune.

AK nuk ka paraqitur asnjë analizë teknike që arsyeton këtë nivel përvoje.

Për rrjedhojë, kjo kërkesë është qartazi jashtë proporcionit me natyrën e projektit.

PRETENDIMI NR. 7

Kërkesa për murator të certifikuar është joproportionale

Nga paramasa rezulton se janë paraparë vetëm rreth 16 m² mure të reja.

Ky volum është minimal dhe nuk justifikon kërkesën për murator të certifikuar apo me kualifikime të veçanta profesionale.

AK nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse një punim i tillë kërkon certifikim të veçantë.

Për rrjedhojë, kjo kërkesë është e tepruar dhe kufizuese.

PRETENDIMI NR. 8

Kërkesa për punëtor të certifikuar për hidroizolim është pa bazë teknike

AK ka kërkuar punëtor të certifikuar për hidroizolim.

Megjithatë, në paramasë nuk figuron asnjë pozicion që lidhet me punime hidroizolimi.

Në mungesë të punimeve të tilla, nuk ekziston asnjë bazë teknike që justifikon këtë kërkesë.

Për rrjedhojë, kriteri është vendosur pa lidhje me objektin e kontratës.

PRETENDIMI NR. 9

Kërkesa për gjenerator 300 kVA është joproportionale

AK ka kërkuar gjenerator me kapacitet minimal 300 kVA.

Punimet e parapara në projekt nuk përfshijnë procese industriale apo pajisje me konsum të lartë energjetik.

AK nuk ka paraqitur asnjë llogaritje apo analizë teknike që justifikon nevojën për një kapacitet të tillë.

Për rrjedhojë, kjo kërkesë është e tepruar dhe kufizon konkurrencën në mënyrë të pajustificuar.

PRETENDIMI NR. 10

Kërkesa për frezë të montuar në ekskavator është joproportionale

Sipas paramasës parashihet vetëm një segment i kufizuar i kanalizimit.

Për realizimin e këtyre punimeve nuk nevojitet pajisje e specializuar si freza e montuar në ekskavator.

AK nuk ka dhënë asnjë arsytim teknik për domosdoshmërinë e kësaj pajisjeje.

Prandaj kjo kërkesë nuk është në raport me vëllimin real të punimeve.

PRETENDIMI NR. 11

Kërkesa për dy kontejnerë minimum 15 m2 është joproportionale

AK ka kërkuar dy kontejnerë me sipërfaqe minimale 15 m2.

Organizimi i kantierit është përgjegjësi e operatorit ekonomik dhe duhet të përshtatet sipas metodologjisë së realizimit të punimeve.

AK nuk ka arsyetuar se si numri dhe madhësia e kontejnerëve ndikon në cilësinë e realizimit të kontratës.

Për rrjedhojë, kjo kërkesë paraqet kufizim të panevojshëm të konkurrencës.

PRETENDIMI NR. 12

Vendimi i AK-së nuk përmban arsyetim konkret dhe nuk trajton pretendimet e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim

Përveç faktit që kriteret e kontestuara janë joproporcionale, AK gjatë shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim nuk ka trajtuar në mënyrë individuale asnjërin nga pretendimet e paraqitura nga operatori ekonomik.

Vendimi i AK-së përmban vetëm konstatime të përgjithshme se kriteret janë në përputhje me natyrën e projektit dhe se nuk janë diskriminuese, pa shpjeguar për secilin kriter:

- pse kërkohet;
- me cilat pozicione të paramasës lidhet;
- pse konsiderohet proporcional;
- pse nuk kufizon konkurrencën.

Për rrjedhojë, AK nuk ka kryer një shqyrtim real dhe efektiv të Kërkesës për Rishqyrtim, por ka nxjerrë një vendim formal (blanko), pa analizuar pretendimet konkrete të operatorit ekonomik dhe pa ofruar arsyetim të mjaftueshëm juridik e teknik për refuzimin e tyre.

Ky veprim e bën vendimin e AK-së të paarsyetuar dhe të papërshtatshëm për kontroll efektiv nga OSHP.

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Kërkesa për Rishqyrtim e OE “TREING SH.P.K.” lidhur me enderin “Instalimi nxemjeve qendrore-riparimi i kulmit ne SHFMU Xheladin Gashi-Plaku Komoran

ANULOHET njoftimi për kontratë i AK - KOMUNA GLLOGOC.

AK të angazhohet seriozisht dhe të eliminoj kërkesat kufizuese nga dosja e tenderit. Gjithashtu të rishikohen të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit siç janë certifikimet, kërkesat për stafin e sidomos ato për pajisjet e nevojshme etj. duke i harmonizuar ato me dhe makineritë.

LPP-në dhe RRPP-001/2022 si dhe duke ia përshtatur natyrës së projektit dhe shpenzimit

efikas, efektiv e veçanërisht shpenzimit ekonomik të parasë publike.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse nuk largohen kriteret e tilla që na e pamundësojnë tenderimin në këtë projekt janë të konsiderueshme në fushën financiare që përbëjnë fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*